



VENDIM

Nr. 11, Datë 25/10/2016

Për

**MIRATIMIN E PLANEVE MËSIMORE NË FAKULTETIN E MUZIKËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2016 - 2017**

Në zbatim të, nenit 3, (*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*), neni 38 (*Funksionet e Senatit Akademik*), neni 39 (*Rektori*), të ligjit nr. 80/2015, "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", dhe pasi u njoh me dokumentacionin e dërguar nga Fakulteti i Muzikës, si dhe të prezantuar nga Drejtuesit e Departamenteve, ku gjendeshin të përfshira të gjitha programet e studimit të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Shkencave, Master i Arteve dhe Master Profesional, për vitin akademik 2016-2017,

VENDOSI

1. Miratimin e planeve mësimore të Fakultetit të Muzikës, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Shkencave, Master i Arteve dhe Master Profesional, për vitin akademik 2016-2017 sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi të dërguar nga Fakulteti i Muzikës.
2. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Sekretaria mësimore dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve;
3. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA